



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 243, datë 29.12.2021

MBI
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË DHE ZGJERIMIT TË LICENCËS SË
SHOQËRISË “BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Shoqëria “Banka e Parë e Investimeve, Albania” sh.a., disponon licencën nr. 12, datë 29.09.2010 si: “Shoqëri brokerimi (broker-dealer) në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në Bursë dhe në tregun me pakicë”, sipas Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, i shfuqizuar. Licenca si shoqëri brokerimi, nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara, është e njëjtë me shërbimet e investimit si: Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit, ekzekutim urdhërash, të përcaktuara në Ligjin nr. 62/2020.

Shoqëria “Banka e Parë e Investimeve, Albania” sh.a., disponon dhe licencën nr. 5, datë 29.09.2010 “Për ofrimin e shërbimit të kujdestarit të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, si dhe licencën nr. 2 datë 23.12.2014 “Për obligacionet e shoqërive aksionere dhe të qeverisë vendore”. Referuar Ligjit nr. 62/2020, shërbimi i kujdestarisë apo ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve, konsiderohet shërbim ndihmës.

“Banka e Parë e Investimeve, Albania” sh.a., ka paraqitur raportin e përshtatshmërisë së veprimtarisë me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, si dhe ka depozituar kërkesën për zgjerimin e licencës me qëllim zgjerimin e gamës së instrumenteve financiare që do t’i ofrojë klientëve. Më konkretisht shërbimet e investimit dhe instrumentet financiare që do ofrohen nga “Banka e Parë e Investimeve, Albania” sh.a., janë:

1. Marrja dhe transmetimi i urdhrave në lidhje me një ose më shumë instrumente financiare;

2. Ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve;
3. Tregtimi për llogari të vet.

Shërbimet ndihmëse:

- Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

Instrumentet financiare:

1. Titujt e transferueshëm;
2. Instrumentet e tregut të parasë;
3. Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Për sa më sipër, Bordi i Autoriteit të Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Banka e Parë e Investimeve, Albania” sh.a., me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij, për:**

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit në Tituj e Qeverisë si:

- 1. Marrje dhe transmetim i urdhrave;**
- 2. Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve;**
- 3. Tregtim për llogari të vet.**

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në tituj e Qeverisë dhe obligacioneve të shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore si:

- **Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.**

- 2. Miratimin e zgjerimit të licencës së shoqërisë “Banka e Parë e Investimeve, Albania” sh.a., për:**

A. Instrumentet financiare si më poshtë:

- 1. Titujt e transferueshëm;**
- 2. Instrumentet e tregut të parasë;**
- 3. Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.**

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës “Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve” për të gjitha instrumentet financiare të listuar më sipër.

- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE